

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5868
E martë, 3 shtator 2019
çmimi 0.40 €

Viti i ri shkollor nis me premtimin për ngritjen e cilësisë në arsim | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



OSBE-ja, ME ROL KËSHILLËDHËNËS NË KATËR KOMUNAT NË VERI F. 3

VAZHDOJNË REFORMAT NË SHËRBBIMIN KORREKTUES TË KOSOVËS F. 5

PROFESORI ENVER SOPJANI I BASHKOHET NISMËS SOCIALDEMOKRATE F. 7

EKONOMI



MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË PREMTON ELIMINIMIN E BARRIERAVE TREGTARE ME SHQIPËRINË F. 9

KEK-u: BLOQET E KORPORATËS PO KTHEHEN NË PRODHIM F. 8

SPORT

PREKAZI: ANGLIA FAVORITE, POR KOSOVA NUK DORËZOHET

F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", ISMAJL KURTESHI | FAQE 4-5



LDK-ja është përgjegjëse për dështim të koalicionit parazgjedhor

Sekretari organizativ i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, ka bërë me dije se faktore për moskrijimin e koalicionit parazgjedhor në mes të LV-së dhe LDK-së është kjo e fundit. Në

këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se propozimi i fundit i LV-së për LDK-në ishte i drejtë dhe i plotësonte kërkesat e LDK-së nëse ajo do të dilte partia e parë në

zgjedhjet e 6 tetorit. Kurteshi është shprehur i bindur në fitoren e LV-së edhe pa koalicion parazgjedhor. Madje, sipas tij, kjo lëvizje synon t'i marrë mbi 40 mandate në këto zgjedhje

Rifillimi i dialogut, detyrë e qeverisë së re

Vazhdimi i procesit të dialogut për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë do të jetë një prej detyrave kryesore të qeverisë së re. Kështu kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe analistët politikë. Edhe ambasadorët e vendeve të Quintit po insistojnë për riaktualizimin e agjendës së dialogut pas zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit. Ata kanë vlerësuar se arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse është në interes të Kosovës dhe i kontribuon stabilitetit rajonal | FAQE 3



PDK-ja dhe LB-ja garojnë me listë të përbashkët në zgjedhjet e 6 tetorit | FAQE 7



Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lëvizja për Bashkim (LB) kanë nënshkruar të hënën marrëveshje koalicioni për zgjedhjet parlamentare që do të mbahen më 6 tetor. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, liderët e dy partive kanë shprehur optimizëm për këtë bashkëpunim, duke thënë se bashkë do ta dalin fitues

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

RATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.P.K.
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kocijançiq: Bashkëpunim i ngushtë me Palmerin, dialogun e udhëheq BE-ja

BRUKSEL, 2 SHTATOR - Zëdhënësja e Bashkimit Evropian, Maja Kocijançiq, thotë se BE-ja pret bashkëpunim të ngushtë me të dërguarin special të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer. Në deklaratën e saj për Tanjug, ajo theksoi rolin e ShBA-së në dialogun Beograd - Prishtinë, gjithashtu theksoi se këto bisedime mbahen nën ombrellën e BE-së. "ShBA-ja ka dhënë kontribut të rëndësishëm në punën tonë në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht kur

bëhet fjalë për sukses në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja midis Prishtinës dhe Beogradit. BE-ja dhe ShBA-ja ndajnë një interes të fortë të përbashkët për një Ballkan Perëndimor të qëndrueshëm dhe të prosperuar dhe ne mezi presim ta vazhdojmë bashkëpunimin e ngushtë me ShBA-në dhe Matt Palmerin si i dërguari special i ShBA-së", tha Kocijançiq. Ajo theksoi faktin se BE-ja dhe ShBA-ja kanë punuar kaq ngushtë në Ballkanin Perëndimor deri më

tani, gjithashtu kujtoi se shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, ishte "plotësisht dhe personalisht" e angazhuar në ndërmjetësimin e dialogut si dhe në perspektivat e BE-së për Serbinë, Kosovën dhe tërë Ballkanin Perëndimor. "Ne mirëpresim çdo angazhim për ta mbështetur dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja qoftë ai që vjen nga vendet anëtare, bashkësi ndërkombëtare, veçanërisht nga ShBA-ja", tha Kocijançiq.



Britania lanson fushatën 'Bëhuni gati për Brexit'

Fushata ka nisur të dielën dhe është publikuar edhe në faqen qeveritare duke paralajmëruar se në kuadër të fushatës do të ketë edhe mbishkrime në rrugë dhe reklama televizive

LONDËR, 2 SHTATOR - Qeveria britanike ka lansuar një fushatë informuese për publikun me thirrjen, "Bëhuni gati për Brexit". Fushata ka nisur të dielën dhe është publikuar edhe në faqen qeveritare. Në ditët në vijim është thënë se në kuadër të fushatës do të ketë edhe mbishkrime në rrugë dhe reklama televizive.

Michael Gove, që është i ngarkuar për ta planifikuar largimin e Britanisë pa marrëveshje nga Bashkimi Evropian, ka thënë se reklamat bëjnë thirrje për "ndarje të përgjegjësive" nëse Britania largohet nga blloku evropian pa ndonjë pajtueshmëri më 31 tetor. Është raportuar se fushata do të kushtojë rreth 100 milionë funte britanike, teksa ministrat tentojnë t'i informojnë njerëzit se çfarë do t'u duhet të bëjnë nëse nuk ka ndonjë marrëveshje para afatit të fundit.

Shtetasit britanikë që synojnë të udhëtojnë në Evropë dhe bizneset që eksportojnë në BE është thënë se janë grupet specifike që janë

shënjestruar në këtë fushatë, ka njoftuar rfe.

Teksa ka bërë me dije për fushatën, Gove ka thënë se të siguruarit që Mbretëria e Bashkuar largohet nga BE-ja në një mënyrë të duhur "nuk është vetëm çështje e rëndësisë kombëtare, mirëpo edhe e përgjegjësisë së përbashkët". Gove është kritikuar nga një asociacion për tregti, meqë ai ka pretenduar se nuk do të ketë mungesa të ushqimit të freskët dhe ilaçeve në rast të Brexitit pa marrëveshje.

Kryeministri britanik Boris Johnson ka paralajmëruar të premten se secili tentim nga ligjvënësit për të bllokuar apo shtyrë largimin e Britanisë nga Bashkimi Evropian përtej 31 tetorit, mund të shkaktojë dëm afatgjatë sa i përket besimit publik në politikë. "Nëse e bllokojmë Britaninë nga të larguarit më 31 tetor, nëse një gjë të tillë do ta bëjnë parlamentarët, kjo do të shkaktojë dëm në besimin publik të njerëzve sa i përket politikës", ka



thënë ai për televizionin Sky. "Do të shkaktojë dëm katastrofik në partitë e mëdha në këtë shtet. Kjo gjeneratë politike nuk do të falet për dështim të realizimit të atij premtimi", tha ai.

Johnsoni ka njoftuar javën e kaluar për pezullim të punës së Parlamentit, vetëm disa javë para se të finalizohet procesi i Brexitit.

Ky veprim i tij është interpretuar si tentim për t'i kufizuar veprimet e kundërshtarëve.

Mbretëresha Elizabeta II, sipas këshillës së kryeministrit, ka vendosur për pezullim të punës së Parlamentit nga mesi i shtatorit. Ky vendim ka nxitur kundërshtime të mëdha si në mesin e politikanëve britanikë, ashtu edhe në mesin e

atyre që kundërshtojnë largimin e Britanisë nga blloku evropian pa marrëveshje.

Vendimi për largim të Britanisë nga blloku evropian ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.

Ruçi: Kuvendi funksional dhe me kuorum kushtetues

IRANË, 2 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, deklaroi të hënën se "Kuvendi mbylli sesionin e kaluar dhe fillon këtë sesion parlamentar si një institucion funksional me një kuorum kushtetues, me shumicë të kualifikuar për të miratuar çdo akt ligjor".

Në nisje të sesionit të ri parlamentar, Ruçi tha se "sesioni që

mbyllëm nuk ishte i lehtë, por me gjithë vështirësitë që u shkaktuan nga lënia e mandateve të deputetëve të opozitës, kjo nuk cenoi funksionimin e sistemit tonë politik, produktivitetin dhe rezultatet e Kuvendit".

"Rreth 70 % e mandateve, ose 40 prej 58 mandateve u zëvendësuan nga deputetët e rinj të opozitës. Kjo ndihmoi në rik-



thimin e normalitetit dhe legjitimitetit të Kuvendit. Kuvendi ushtroi me intensitet funksionin kryesor, atë legjislativ", tha Ruçi. Sipas tij, gjatë sesionit të kaluar u depozituan 64 projektligje dhe u miratuan 57 gjithsej, ose 2 më shumë sesa në të njëjtin sesion të vitit të kaluar. "U miratuan 76 vendime, u miratuan 5 ligje me 3/5, ndërkohe që vitin e shkuar me 3/5 nuk u

votua asnjë projektligj; u miratuan 28 ligje me konsensusin e opozitës, ose 21 ligje më shumë sesa në periudhën janar-korrik 2018. Deputetët morën 19 nisma ligjore ose 8 më shumë se viti i kaluar, njëra prej të cilave kishte të bënte me ndryshimet në Kodin Penal, deputetët e opozitës kërkuan 6 interpelanca, ose 2 më shumë se në vitin e kaluar prej të cilave u zhvilluan 5", tha Ruçi.

Rifillimi i dialogut, detyrë e qeverisë së re

Vazhdimi i procesit të dialogut për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë do të jetë një prej detyrave kryesore të qeverisë së re. Kështu kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe analistët politikë. Edhe ambasadorët e vendeve të Quintit po insistojnë për riaktualizimin e agjendës së dialogut pas zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit. Ata kanë vlerësuar se arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse është në interes të Kosovës dhe i kontribuon stabilitetit rajonal

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Analistët politikë, njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare si dhe faktori ndërkombëtar presin që procesi i dialogut Kosovë - Serbi të rifillojë pas krijimit të institucioneve të reja. Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka thënë se agjenda e dialogut do të riaktualizohet menjëherë pas zgjedhjeve të 6 tetorit. Ai ka thënë se dialogut do të vazhdojë edhe nëse në krye të qeverisë së re do të jenë ata që e kanë kundërshtuar këtë proces, madje edhe me mjete të paligjshme. Sipas Gashit, thirrja e fundit e Quintit tregon se ky proces duhet të dinamizohet menjëherë pas konstituimit të institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet. "Agjenda e dialogut do të riaktualizohet menjëherë pas zgjedhjeve. Për këtë ka insistim dhe angazhim të partnerëve tanë kryesorë ndërkombëtarë si nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), po ashtu edhe nga vendet më të fuqishme të Bashkimit Evropian (BE). Thirrja e fundit e Quintit tregon se ky proces duhet të dinamizohet menjëherë pas konstituimit të institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet. Kjo mendoj do të ndodhë pavarësisht kush do ta udhëheqë qeverinë e ardhshme, madje edhe nëse në krye të ekzekutivit do të jenë

partitë që për një kohë të gjatë janë deklaruar kundër dialogut dhe kanë përdorur mjete të paligjshme për ta penguar atë", ka deklaruar Gashi në një intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re".

Edhe profesori tjetër i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blërim Reka, ka thënë se qëndrimi i Quintit, duke i trajtuar të dyja palët në mënyrë të barabartë, ka dhënë shpresë se procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë mund të rifillojë me një mandat të ri, format të ri dhe me trajtim të ri të barabartë ndaj dy palëve negociuese. "Konsideroj se Quinti, me një qëndrim të tillë të ekuidistancës ndaj dy palëve të barabarta negociuese, dha shpresë për rifillimin e dialogut, por tash me një mandat të ri, format të ri dhe me trajtim të ri të barabartë ndaj dy palëve negociuese. Fundja, qëndrimin e Quintit pak a shumë e kishte paralajmëruar iniciativa e fundit Merkel - Makron, e filluar në pranverë në Berlin dhe me gjasë me vazhdim në vjeshtë në Paris. Dueti 'Merkron' i dy fuqive kryesore të BE-së, në një mënyrë ishte kritik ndaj qasjes së gjertanishme shtatëvjeçare të ndërmjetësimit të dialogut të Brukselit, sidomos të rrëshqitjes së ish-ndërmjetësues së tij (nga gushti i vitit të kaluar) në pranimin implicit edhe të negociimit të ndryshimeve



kufitare, që nuk ishte as mandat i saj e as i Komisionit Evropian", është shprehur Reka për gazetën "Epoka e re".

Ndërsa ambasadorët e vendeve të Quintit kanë thënë se zgjedhjet e 6 tetorit dhe formimi i qeverisë së re ofrojnë mundësi për rifillimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ata kanë vlerësuar se arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse është në interes

të Kosovës dhe i kontribuon stabilitetit rajonal. "Siç edhe vunë në dukje qeveritë tona së fundmi, zgjedhjet dhe formimi i qeverisë së re ofrojnë një mundësi për rifillimin urgjent të bisedimeve me Serbinë me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, politikisht të qëndrueshme dhe ligjrisht të obligueshme, që i kontribuon stabilitetit rajonal. Kjo qartësisht

është në interesin e Kosovës. Për të arritur një marrëveshje Qeveria e Kosovës do të ketë nevojë për fleksibilitet për të negociuar dhe aftësi për të artikuluar një vizion pozitiv për marrëdhënien e ardhshme të shtetit me Serbinë dhe dobite ekonomike dhe të sigurisë që ajo mund t'i sjellë Kosovës", është theksuar në deklaratën për medie të Quintit.

OSBE-ja, me rol këshillëdhënës në katër komunat në veri

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të hënën ka marrë vendim që misioni i OSBE-së të ketë rol këshillëdhënës në veri në zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit. Me këtë rast, kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka thënë se edhe në këto zgjedhje është e nevojshme një prani e OSBE-së në katër komunat veriore të Kosovës. "Tani meqë kemi zgjedhje të parakohshme vendos

që duhet të ketë përsëri një prani të tillë. Do të ishte mirë të jetë prania e tyre për shkak të këshillave të qendrave të tyre sikur edhe në votimet e kaluara", ka deklaruar Daka.

Me shumicë votash të anëtarëve të KQZ-së është vendosur që sot (e martë) të nënshkruhet marrëveshja me përfaqësues të BE-së për zgjedhjet e parakohshme. Po ashtu, në mbledhjen e së hënës KQZ-ja ka marrë vendim për kufiz-

imin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit.

Me këtë vendim është përcaktuar kufiri i shpenzimeve të fushatës për subjektet politike në shumën prej 986 233 eurosh, pra 0.50 euro për votues të regjistruar. Ky vendim mbështetet në listën preliminare të votuesve. Sipas KQZ-së, numri i votuesve sipas listës preliminare të regjistrimit civil është 1 milion e 972 mijë e 466.



Flet për "Epokën e re", Ismajl Kurteshi

LDK-ja është përgjegjëse për dës



Sekretari organizativ i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, ka bërë me dije se faktore për moskrijimin e koalicionit parazgjedhor në mes të LV-së dhe LDK-së është kjo e fundit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se propozimi i fundit i LV-së për LDK-në ishte i drejtë dhe i plotësonte kërkesat e LDK-së nëse ajo do të dilte parti e parë në zgjedhjet e 6 tetorit. Kurteshi është shprehur i bindur në fitoren e LV-së edhe pa koalicion parazgjedhor. Madje, sipas tij, kjo lëvizje synon t'i marrë mbi 40 mandate në këto zgjedhje

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Sekretari organizativ i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, e ka bërë përgjegjëse LDK-në për dështimin e koalicionit parazgjedhor LV-LDK. Ai ka deklaruar se propozimi i fundit i liderit të LV-së, Albin Kurti, ia ka mundësuar LDK-së ta ketë

edhe postin e kryeministrit nëse ajo parti do të dilte e para në zgjedhje. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Kurteshi është shprehur i bindur në fitoren e këtij subjekti politik edhe pa koalicion parazgjedhor. "Sipas fakteve që i argumentova më lart, ato nuk nxjerrin përgjegjëse tjetër përveç LDK-së. Nuk ka mundësi që Lëvizja

Vazhdojnë reformat në Shërbimin Korrektues të Kosovës

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije të hënën se deri më tani në kuadër të reformave ShKK-ja ka arritur shumicën e objektivave, përfshirë këtu ato logjistike, trajnimin e zyrtarëve si dhe luftimin e dukurive negative brenda institucioneve të këtij shërbimi. "Pas një kohe të gjatë diskutimesh kemi gjetur modalitetet dhe mënyrat më të mira dhe kemi arritur në përfundim që t'i ndjekim praktikën e rotacionit me qëllim që këto praktika të përcillen nga një institucion në një institucion tjetër



Shërbimi Korrektues i Kosovës
Korektivna Služba Kosova
Kosovo Correctional Service

me arsyen e vetme që të jemi më të suksesshëm dhe më efikas në punën tonë. Sot së bashku me të gjithë aktorët kyçë kemi arritur ta ndryshojmë imazhin e ShKK-së falë angazhimit dhe punës së përbashkët të stafit dhe ballafaqimit me sfidat nëpër të cilat ka kaluar", është thënë në komunikatë.

Më tutje është theksuar se institucionet e sigurisë, Policia e Kosovës, FSK-ja dhe Dogana, vetëm përmes rrotacionit të stafit, prej një qendre në qendrën tjetër, kanë arritur t'i eliminojnë dukuritë negative. "Pa dyshim ky rrotacion ka imputet e veta, prandaj edhe ShKK do të testojë një metodologji të tillë dhe

sigurisht kjo do t'i japë efektet e veta pozitive. Me fillimin e këtij rotacioni kemi pasur parasysh shumë kritere të tjera, përfshirë këtu edhe lehtësimin e udhëtimit dhe transportin e zyrtarëve të cilët kanë filluar prej 1 shtatorit të këtij viti dhe do të vazhdojnë deri më 1 dhjetor, për të vazhduar edhe me rotacione të tjera të këtij lloji edhe në të ardhmen", është theksuar në komunikatën për medie të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK). Në vazhdimin e kësaj komunikate është theksuar se këto të arritura të Shërbimit Korrektues të Kosovës pa

dyshim se janë rezultat i angazhimit maksimal të shumë burrave dhe grave të cilët janë pjesë e ShKK-së. "Hipoteza e cila e ka përcjellë ShKK-në ndër vite e që po lë një shije të keqe për ne edhe sot është nepotizmi, po edhe favorizimet. Ne jemi duke punuar në mënyrën më të mirë të mundshme për t'i gjetur metodat dhe metodologjitë për ta dëshmuar të kundërtën e saj, dhe duhet të dëshmojmë se vërtet jemi institucion me vlera dhe kredibilitet të lartë, pavarësisht se kjo do një sakrificë dhe mund më të theksuar", është thënë në komunikatën e ShKK-së.

htim të koalicionit parazgjedhor

vendin në këto zgjedhje. "Ne nuk kemi asnjë vërejtje në zonzjën Osmani, por ne konsiderojmë se Albin Kurti është politikani më i përshtatshëm dhe më i afti për ta kryer punën e kryeministrit, dhe Lëvizja Vetëvendosje është subjekt i vendosur që ta luftojë korrupsionin, krimin e organizuar dhe ta kemi një program zhvillimor për vendin i cili i duhet Kosovës", ka deklaruar Kurteshi.

Më tej, ai ka vlerësuar se fryma për ndryshim që është krijuar së fundi e bën të pashmangshme fitoren e LV-së më 6 tetor. "Bazuar në sondazhet që ne po i përcjellim, dallimet mes neve dhe të tjerëve janë tepër të mëdha. Kandidati i LV-së për kryeministër në krahasim me të tjerët prin bindshëm. Pra, fitorja e LV-së është e sigurt, ne më 6 tetor do të jemi subjekti i parë dhe kandidati ynë për kryeministër do të ketë vota shumë më tepër sesa kandidati i dytë dhe të tjerët", është shprehur ai.

Kurteshi ka folur edhe për mundësinë e koalicioneve të reja pas zgjedhjeve. Sipas tij, është zotim i LV-së dhe LDK-së që të bëjnë përpjekje për formimin e koalicionit qeverisës. "Është një lloj zotimi i dy subjekte, LV-së dhe LDK-së, që edhe pas zgjedhjeve të bëjmë përpjekje që ta formojnë një koalicion qeverisës. Mendoj se atëherë do ta kemi shumë më lehtë bashkëpunimin, sepse pas rezultatit të zgjedhjeve do të dihet se cila është fuqia politike e secilit subjekt", ka thënë Kurteshi.

"Epoka e re": Z. Kurteshi, edhe pas shumë përpjekjesh, nuk ndodhi koalicioni parazgjedhor me LDK-në. Pse?

Kurteshi: Mendoj se për këtë përgjigjen duhet ta japë LDK-ja, e cila e ka pasur mundësinë të futet në koalicion duke iu plotë-

suar të gjitha kërkesat. Zyrtarët e LDK-së vazhdimisht deklarohen se LDK-ja është subjekti i parë politik në Kosovë. Me këtë rast, ne propozuam që të futemi në një listë pa kandidat të përcaktuar për kryeministër, duke e vendosur në listë të parën kandidaten e tyre. Por, ata nuk e dëshiruan këtë propozim, sepse nuk janë të sigurt se partia e tyre do të dalë e para, ose kanë ndonjë arsye tjetër që ne nuk e dimë. Pas refuzimit të kësaj mundësie përgjegjësia bie mbi LDK-në. Edhe kështu siç jemi, ne nuk jemi keq, sepse në Kosovë është krijuar fryma se në këto zgjedhje do të ndodhë ndryshimi dhe të gjithë e dinë se ndryshimin mund ta sjellë vetëm Lëvizja Vetëvendosje me kryeministër Albin Kurtin.

"Epoka e re": Sipas jush, faktori kryesor për moskrijimin e koalicionit LV-LDK është kjo e fundit?

Kurteshi: Sipas fakteve që i argumentova më lart, ato nuk nxjerrin përgjegjëse tjetër përveç LDK-së. Nuk ka mundësi që Lëvizja Vetëvendosje të ketë përgjegjësi edhe në rastin kur LDK-ja nuk e pranon ofertën që ia krijon mundësinë ta ketë edhe kryeministrin, nëse është partia e parë siç po pretendon.

"Epoka e re": Pse kandidatura e znj. Osmani nuk është e pranueshme për LV-në?

Kurteshi: Ne nuk kemi asnjë vërejtje në zonzjën Osmani, por ne konsiderojmë se Albin Kurti është politikani më i përshtatshëm dhe më i afti për ta kryer punën e kryeministrit, dhe Lëvizja Vetëvendosje është subjekt i vendosur që ta luftojë korrupsionin, krimin e organizuar dhe ta kemi një program zhvillimor për vendin, i cili i duhet Kosovës. Sepse, siç po shohim, vendi ka stagnuar në të gjitha fushat. Ne kemi nevojë për

arsim cilësor, për shërbime më të mira shëndetësore, kemi nevojë për administratë më të organizuar, për investime më të mëdha në bujqësi dhe në siguri. Pra, nuk është se ne kemi ndonjë vërejtje për zonzjën e propozuar nga LDK-ja, por alternativa që ne kemi ofruar është shumë më e mirë për vendin në këto zgjedhje.

"Epoka e re": Z. Kurti ende nuk është zyrtarizuar kandidat i LV-së për kryeministër. Kur do të ndodhë kjo?

Kurteshi: Lëvizja Vetëvendosje pas dy ditësh do ta ketë mbledhjen, në të cilën formalisht do të zyrtarizohet Kurti kandidat për kryeministër. Meqenëse deri tash nuk ka pasur ndonjë pretendent tjetër nga Lëvizja për kandidat për kryeministër, mendoj se ky zyrtarizim do të ndodhë së shpejti. Megjithatë, Këshilli i Përgjithshëm i LV-së e thotë fjalën e fundit përmes votës.

"Epoka e re": Cila do të jetë oferta kryesore e LV-së në këto zgjedhje përmes së cilës do ta kërkojë votën e qytetarëve?

Kurteshi: Oferta jonë kryesore, në vija të trasha, është ndryshim total i mënyrës së udhëheqjes së vendit. Pra, stop keqpërdorimeve, stop korrupsionit dhe krimit të organizuar, punë të planifikuar për zhvillim të gjithëmbarshtëm brenda vendit, ndërtim të raporteve të mira, pra raporte partneriteti e jo serviliteti me ndërkombëtarët dhe fqinjët. Do të jetë një formë krejt ndryshe e udhëheqjes së vendit, e cila garanton perspektivë për të gjithë qytetarët, e sidomos për të rinjtë të cilët po e kanë të vështirë të jetojnë në këtë kohë. Ata sot nuk gjejnë punë, janë të trajtuar keq dhe nuk kanë shërbime shëndetësore.

"Epoka e re": Siç po shihet, do ta

kemi një garë interesante për vend të parë në këto zgjedhje. Pretendente për të fituar janë katër subjekte të mëdha politike. Sa sfiduese do të jetë kjo për LV-në?

Kurteshi: Bazuar në sondazhet që ne po i përcjellim, dallimet mes neve dhe të tjerëve janë tepër të mëdha. Kandidati i LV-së për kryeministër në krahasim me të tjerët prin bindshëm. Pra, fitorja e LV-së është e sigurt, ne më 6 tetor do të jemi subjekti i parë dhe kandidati ynë për kryeministër do të ketë vota shumë më tepër sesa kandidati i dytë dhe të tjerët.

"Epoka e re": Sipas sondazheve që po i përmendeni, sa është dallimi mes subjektit të parë dhe të dytë?

Kurteshi: Çka do që them mendoj se rezultatet do të jenë befasuese edhe për mua. Mirëpo dallimi do të jetë jashtëzakonisht i madh. Kësaj radhe Lëvizja do të ketë deputetë shumë më tepër sesa kemi herën e kaluar. Siç e dini, herën e kaluar kemi qenë të parët me 32 deputetë, por tash numri i deputetëve të LV-së në Kuvend do të jetë dukshëm më i madh.

"Epoka e re": Sa deputetë pritni t'i keni?

Kurteshi: Besoj se do ta kalojmë numrin 40.

"Epoka e re": Meqenëse jeni kaq të bindur në fitore, a keni menduar se me kënd do ta mund ta formoni qeverinë pas zgjedhjeve?

Kurteshi: Është një lloj zotimi i dy subjekteve, LV-së dhe LDK-së, që edhe pas zgjedhjeve të bëjmë përpjekje që ta formojnë një koalicion qeverisës. Mendoj se atëherë do ta kemi shumë më lehtë bashkëpunimin, sepse pas rezultatit të zgjedhjeve do të dihet se cila është fuqia politike e secilit subjekt. Pastaj do të sillemi dhe do t'i ndajmë përgjegjësitë bazuar në fuqinë politike që do ta fitojmë nga përkrahja e qytetarëve më 6 tetor.

Vetëvendosje të ketë përgjegjësi edhe në rastin kur LDK-ja nuk e pranon ofertën që ia krijon mundësinë ta ketë edhe kryeministrin, nëse është partia e parë siç po pretendon", ka thënë Kurteshi.

Ai ka thënë se nuk kanë asgjë kundër Vjosa Osmanit, kandidates së LDK-së për kryeministre, por LV-ja mendon se Albin Kurti është alternativë më e mirë për


Instituti i Shëndetësisë Publike bën thirrje për vaksinimin e fëmijëve

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka kërkuar që të vaksinohen të gjithë fëmijët sipas kalendarit të rregullt në mënyrë të mbrohen nga sëmundjet ngjitëse. Ky Institut ka theksuar se në të gjitha shtetet e Evropës është përhapur fruthi. Megjithatë, sipas IKShPK-së, në Kosovë nuk ka epidemi të fruthit sepse janë vaksinuar mbi 95 për qind e fëmijëve. "Prindër të nderuar, urime viti i ri shkollor 2019/2020! Të vaksinohen të gjithë fëmijët sipas kalendarit të rregullt që të mbrohen nga sëmundjet ngjitëse vaksinë pre-

ventabile! U bëjmë apel të gjitha komuniteteve, posaçërisht prindërve dhe liderëve të RAE komunitetit, të rekomandojnë që të gjithë fëmijët e pavaksinuar të paraqiten në QKMF-të e komunave përkatëse për ta kompletuar kalendarin e vaksinimit. Pothuaj në të gjitha shtetet e Evropës është shënuar epidemi e fruthit. Pothuaj në të gjitha shtetet ballkanike është shënuar epidemi e fruthit. Në Kosovë nuk ka epidemi të fruthit sepse janë vaksinuar mbi 95 për qind e fëmijëve. Vaksinoni fëmijët që t'i keni të shëndoshë!", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.



Viti i ri shkollor nis me premtimin për ngritjen e cilësisë në arsim



ulen sot në bankat e shkollës, duke nisur kështu një ndër rrugët më të bukura të jetës, rrugën e diturisë. Njëherësh uroj edhe mësimdhënësit, ata që nëpërmjet punës së tyre fisnike në përgatitjen e brezit të ri, kontribuojnë drejtpërdrejt në të ardhmen e vendit. Urime, gjithashtu, prindërve për rrugën e përm-bushjes nëpërmjet shkollimit, të ëndrrave më të mira që ata kanë për fëmijët e tyre! I siguroj ata se sakrificat që bëjnë për t'u mundësuar fëmijëve arsimim sa më cilësor, një ditë do të shpërblehet", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor ka uruar të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit e arsimit parauniversitar për një vit të suksesshëm shkollor. "Veçanërisht urime për fatosat të cilët nga sot nisin një etapë të re të jetës së tyre. Shpreh mirënjohjen time për të gjithë mësimdhënësit për përkushtimin dhe angazhimin e tyre, të cilët edhe në kohët më të vështira nuk hoqën dorë nga edukimi dhe arsimimi i fëmijëve tanë. Urime nxënës dhe mësimdhënës. Qoftë një vit i mbarë për të gjithë ju!", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Në shumicën e shkollave të Republikës së Kosovës ka filluar viti i ri shkollor 2019/2020.

Në shumicën e shkollave të Republikës së Kosovës ka filluar viti i ri shkollor 2019/2020. Me këtë rast drejtuesit e institucioneve qendrore kanë uruar nxënësit dhe mësimdhënësit për një vit shkollor të mbarë dhe të suksesshëm. Ata kanë premtuar ngritjen e cilësisë në arsim

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Viti i ri shkollor 2019/2020 ka filluar me zotimin e zyrtarëve qeveritarë për ngritjen e cilësisë në arsim. Ministri në largim i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqyri Bytyqi, ka thënë se duke e ngritur cilësinë në arsim sigurohet një e ardhme më e mirë për fëmijët si dhe u hapet rruga që të jenë konkurrentë me moshatarët e tyre të vendeve të zhvilluara në çdo kohë. "Të nderuar mësimdhënës, të dashur nxënës dhe prindër, sot po shënojmë së bashku një ditë të veçantë, fillimin e vitit të ri shkollor dhe në këtë ditë uroj që të keni motivin e duhur dhe përkushtimin për të arritur rezultate sa më të mira gjatë këtij viti. Duke e ngritur cilësinë në arsim, ne u sigurojmë fëmijëve tanë të ardhme më të mirë dhe u hapim rrugën që të jenë konkurrentë me moshatarët e tyre të vendeve të zhvilluara në çdo kohë", ka deklaruar ai.

Sipas Bytyqit, Kosova e së ardhmes varet nga puna e mësimdhënësve dhe nxënësve. "Në këtë ditë të veçantë, uroj në veçanti vogëlushët që këtë vit kanë filluar klasën e parë, duke shënuar kështu ditën e parë të rrugëtimit. Kosova e së ardhmes varet nga puna e mësimdhënësve dhe nxënësve, por edhe shumë aktorëve të tjerë! Prandaj, të gjithë

së bashku të punojmë me përkushtim për të ardhmen e fëmijëve tanë, për të ardhmen e shtetit tonë", është shprehur ministri Bytyqi.

Edhe kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, ka shprehur përkushtimin për rritjen e cilësisë së edukimit sipas standardeve evropiane. "Nuk ka simbolikë më të fuqishme se të fillojë viti i ri shkollor me një shkollë moderne si ajo, që e inauguroam sot në Tërmenjë të Suharekës. Ky projekt i komunës, i përfunduar për një vit, si rezultat i angazhimit të kryetarit Bali Muharremaj, dëshmon përkushtimin tonë për edukimin. Si qeveri kemi rritur buxhetin për arsimin për 12% dhe kemi miratuar Ligjin për arsimtarët e viteve '90 që ua njeh atyre të drejtat e mohuara për dy dekada, kurse me Ligjin e pagave kanë përfutur rritje edhe mësuesit dhe arsimtarët. Jemi të përkushtuar për rritjen e cilësisë së edukimit sipas standardeve evropiane", ka deklaruar Haradinaj.

Ndërsa presidenti Hashim Thaçi ka thënë se në dy dekadat e fundit është investuar në infrastrukturë, modernizim të kurrikulave dhe objekteve shkollore kurse tani, sipas tij, është koha ta nxisim cilësinë si parakusht për forcimin e përgatitjes profesionale të fëmijëve tanë. "Në shkollat e Kosovës sot hapen dyert për fillimin e vitit të ri shkollor 2019/2020, ku për shumë nxënës fillon një rrugëtim

i rëndësishëm për ta dhe familjet e tyre. Por, suksesi i nxënësve që sot për herë të parë vijnë në klasën e parë do ta përcaktojë nesër fatin dhe të ardhmen e gjithë shoqërisë dhe shtetit të Kosovës. Në dy dekadat e fundit kemi investuar në infrastrukturë, kemi modernizuar kurrikulat dhe objektet shkollore. Tani është koha që ta nxisim cilësinë si parakusht për forcimin e përgatitjes profesionale të fëmijëve tanë. Urime fillimi i vitit të ri shkollor të gjithë nxënësve, mësuesve dhe prindërve të Kosovës!", ka shkruar

Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor nxënësit dhe mësimdhënësit i ka uruar edhe ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. "Me këtë fotografi nga shkolla e parë shqipe në Stubëll, dua t'i uroj të gjithë nxënësit e Kosovës për ditën e parë të shkollës. Shpresoj se ky vit të jetë sa më i mbarë, i frytshëm e me rezultate sa më të mira për ta! Një urim veçanërisht të përzemërt e përcjell për ata nxënës që për herë të parë do të



74 fëmijë të kthyer nga Siria vazhdojnë vitin shkollor

Prishtinë, 2 shtator - Ministri në detyrë i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se vitin e ri shkollor 2019/2020 do ta vazhdojnë edhe fëmijët e riatdhesuar nga Siria. Ai ka thënë se nuk ka qenë aspak e lehtë misioni për kthimin e 74 fëmijëve nga Siria. "Nga sot fillon një periudhë e re për fëmijët tanë. Në shkollat e

republikës që janë burim i dijes dhe socializimit, mësuesit i presin krahëhapur mijëra fëmijë për të ecur bashkërisht me ta në rrugën e ndërtimit të së ardhmes. Ky fillimvit shkollor është akoma më i veçantë. Jam shumë i lumtur që sot në bankat shkollore do të ulen edhe fëmijët e kthyer nga konflikti në Siri. Nuk

ka qenë aspak e lehtë ta drejtojmë një mision të tillë, por kam qenë i bindur se ka qenë vendim i drejtë që të marrim përgjegjësi për këta fëmijë dhe t'i kthejmë në vendin tonë. 74 fëmijë shqiptarë i kemi nxjerrë nga tmerri i luftës, për t'iu dhënë një mundësi të re si çdo moshatar i tyre. Askund më mirë se në

shkollë nuk gjendet një mundësi e tillë", ka deklaruar Tahiri. Ai ka bërë thirrje që këta fëmijë të përkrahen dhe të inkurajohen për të nxënë dije në mënyrë që ata të bëhen pjesë e jetës sociale që zhvillohet brenda shkollave tona. "Me kthimin e tyre jo vetëm se kemi shfaqur një anë njerëzore të vlerave tona si shoqëri, por

edhe kemi vendosur një standard të ri në rrafshin global, që sot është referencë edhe për vendet më të zhvilluara demokratike. Me këtë rast, këtyre fëmijëve në veçanti dhe të gjithë fëmijëve të Republikës së Kosovës që filluan shkollën, u dëshiroj shëndet dhe mësimnxënje të suksesshme!", ka thënë ministri Tahiri.

PDK-ja dhe LB-ja garojnë me listë të përbashkët në zgjedhjet e 6 tetorit

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lëvizja për Bashkim (LB) kanë nënshkruar të hënën marrëveshje koalicioni për zgjedhjet parlamentare që do të mbahen më 6 tetor. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, liderët e të dy partive kanë shprehur optimizëm për këtë bashkëpunim, duke thënë se bashkë do të dalin fitues

"Epoka e re"



PRISHTINË, 2 SHTATOR - Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli dhe lideri i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, kanë nënshkruar të hënën marrëveshje koalicioni për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit. Sipas kësaj marrëveshje, kandidatët për deputetë nga Lëvizja për Bashkim do të jenë pjesë e përbashkët e një liste me kandidatët për deputetë të Partisë Demokratike të Kosovës. Pas nënshkrimit të marrëvesh-

jes, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se do të punojnë bashkërisht për perspektivën e vendit. "Kemi qenë bashkë në luftën për liri, jemi bashkë edhe tani në paqe për Kosovën tonë perëndimore, në luftën tonë kundër nepotizmit, hapjes së perspektivës për rini, për ndërmarrësi, për fuqizimin

ekonomik të Kosovës dhe për orientimin tonë të pakompromis euroatlantik", ka thënë ai, duke shtuar se bashkë do të dalin fitues në zgjedhjet e 6 tetorit. "Do të bëjmë fushatë të qetë për qytetarët tanë, për kombin tonë, për të dalë fitues vetëm për Kosovën. Për të mos mundur askënd, por për të dalë

fitimtarë Kosova dhe PDK-ja", ka deklaruar ai. Kurse kryetari i LB-së, Valon Murati, ka deklaruar se edhe zyrtarët e kësaj partie do ta ngrehin zërin në luftimin e dukurive negative. "Lëvizja për Bashkim do të bëjë përpjekje ashtu sikurse deri tash, ta përçojë zërin e qytetarëve, ta

përçojë idenë e luftës pa kompromis kundër korrupsionit, nepotizmit dhe të gjitha dukurive negative. Po shpresoj që një traditë e bashkëpunimit tonë ka lënë gjurmë dhe do të përpiqemi që bashkërisht të punojmë për të ardhmen e Kosovës dhe të rinisë", ka thënë Murati.

Profesori Enver Sopjani i bashkohet Nismës Socialdemokrate



PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ish-rektori i Universitetit të Prizrenit, Enver Sopjani, ka aderuar në partinë Nisma Socialdemokrate. Ardhjen në këtë subjekt politik të tij e ka bërë publike përmes një konference për medie kryetari i Nismës, Fatmir Limaj, i cili ka thënë se ka kënaqësinë t'i njoftojë qytetarët për aderimin e Sopjanit në këtë parti. "Profesor Enver Sopjani është profesor i 5 universiteteve të Gjermanisë. Ne si Nismë sot jemi shumë më të fuqishëm dhe më komodë në angazhimet tona. Nga sot Enver Sopjani do të jetë këshilltari im si kandidat i ardhshëm për kryeministër dhe krahu im i djathtë në

angazhimet e mia", ka thënë Limaj. Ndërsa Sopjani ka thënë se për të është e rëndësishme që është kyçur në Nismën Socialdemokrate. "Për mua është e rëndësishme t'i shërbej një partie që merret me çështjet sociale. Tashmë Fatmir Limaj e ka dëshmuar se ka një orientim social dhe kombëtar andaj s'keni nevojë të frikësoheni se ai do ta shesë një ditë Kosovën apo të punojë kundër interesave kombëtare". "Kosova nuk ka sigurim social. Kjo është turp sepse njerëzit frikësohen të shkojnë edhe te doktori të shërohen, me mendimin se do të dalin edhe më të sëmurë sesa që shkojnë", ka thënë Sopjani.

Profesori i historisë i bashkohet Vetëvendosjes

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se kësaj lëvizje i është bashkuar historiani i njohur Skender Ferhati. Në llogarinë e tij në "Facebook", Kurti ka shkruar se po vazhdon rritja e lëvizjes anembanë

Kosovës, me njerëz të ditur e të ndershëm. "Dje në Prizren na u bashkua Skender Ferati, profesor i historisë. Dikur ishte nxënës i Behajdin Hallaqit, sot e vazhdon kontributin si mësimdhënës. Babai i Skenderit, Haxhi Ferati, ka qenë i dënuar nga regjimi serb

për aktivitetin politik si zëvendësministër parë i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës. Vazhdon rritja e Lëvizjes sonë anembanë Kosovës, me njerëz të ditur e të ndershëm, të të gjitha moshave e profesioneve", ka shkruar Kurti.



Veseli vizitoi fabrikën e paneleve diellore

PRISHTINË, 2 SHTATOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe kandidati i kësaj partie për kryeministër, Kadri Veseli, i shoqëruar nga ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala, ka vizituar të hënën një fabrikë që punëson mbi 100 të rinj që prodhojnë panele diellore të cilat eksportohen në Evropë. Veseli ka thënë se ka vendosur që me njerëz të rinj, të arsimuar mirë e të pakorruptuar, të punojë në mbështetjen e të rinjve që ata të krijojnë perspektivë në Kosovë. "Me ministrin Muzafer Shala e vizitua fabrikën e prodhimit të paneleve diellore 'Jaha Solar', e cila është më e madhja në rajon dhe

punëson rreth 110 punëtorë. Cilësia e produkteve të teknologjisë së avancuar ka bërë që kjo kompani të rritet dhe të sigurojë tregje të reja. Si ministër i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzaferi e ka ekspertizën e duhur për t'i nxitur të rinjtë dhe për t'i mbështetur idetë e tyre inovative. Me mbështetjen e duhur shumë kompani do të mund të konsolidohen, zgjerohen dhe të hapin vende të reja të punës. Me këtë ekip të të rinjve kompetentë dhe të pakomprometuar, ne do ta luftojmë korrupsionin dhe do të krijojmë mundësi të reja, që të rinjtë tanë të mos emigrojnë, por ta ndërtojnë të ardhmen e tyre në vendin tonë", ka deklaruar Veseli.



KEK-u: Bllloqet e korporatës po kthehen në prodhim



PRISHTINË, 2 SHTATOR (ER) - Ministri në detyrë i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka, ka thënë se ka qenë i trishtuar nga një fotografi që ka pranuar nga qytetarët, ku shihet tym i madh duke dalë nga oxhaku i blllokut "A3" në Obiliq. Me këtë rast, ai ka thënë se nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka

kuptuar se ky tym ka ndodhur për shkak të pastrimit të kazanit të blllokut "A3", i cili për katër muaj ka qenë në remont. Ndaj kësaj situate ka reaguar KEK-u, i cili ka thënë se nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. "Korporata Energjetike e Kosovës njofton opinionin se tymi i zi që po shihet në termo-

centrale është si rezultat i kthimit në prodhim të bllloqeve pas remonteve kapitale. Nuk ka asgjë shqetësuese dhe nuk po ndodhë asgjë e jashtëzakonshme. Ky është një proces i pashmangshëm që zgjatë për disa orë derisa të kthehen bllloqet në prodhim pas revizioneve të përgjithshme. Kjo ndodh prej kur janë instaluar

këto pajisje në Kosovë, tash e 60 vjet më parë. Njëjtë sikurse që ndodhë në çdo vend të botës ku prodhohet energji elektrike nga thëngjilli. Kjo është si rezultat i ndezjes së gjeneratorëve me anë të djegies me naftë dhe zgjatë disa orë derisa të hyjë në sistem dhe të fillojë ndezja e gjeneratorëve me thëngjill", është thënë në njoftimin e KEK-ut.

timin e KEK-ut.

Sipas këtij njoftimi, KEK-u ka njoftuar qytetarët dhe organet përgjegjëse se një pastrim i tillë do të ndodhë gjatë fazës së kthimit të bllloqeve në prodhim. "Prandaj, i kemi njoftuar qytetarët dhe organet përgjegjëse se kjo do të ndodhë gjatë fazës së kthimit të bllloqeve në prodhim pasi kemi përmbyllur me kohë të gjitha remontet në bllloqet e 'TC-A' dhe 'TC-B' në mënyrë që nga shtatori t'i kemi të gjitha kapacitetet në dispozicion të prodhimit të energjisë elektrike. Ajo që shihet sot është si rezultat i kthimit në prodhim të 'Blllokut A3', i cili ka qenë në revizion të përgjithshëm, i ndalur për 4 muaj rresht. Gjithnjë duke u bazuar në programin e dhënë nga OE, gjatë kësaj kohe në dalje të oxhakut do të jetë tymi pak më i theksuar si dhe zhurma që do të paraqitet gjatë testimit. Gjatë fazës së startimit të njësisë gjeneruese një situatë e tillë (tym më i theksuar) është e pashmangshme. Pavarësisht kësaj, ne mbesim me shpresë se do të kemi mirëkuptimin e të gjithë qytetarëve sepse kjo është forma e vetme e cila na mundëson që qytetarëve të vendit t'u ofrojmë stabilitet energjetik edhe gjatë sezonit dimëror", është thënë në njoftimin e KEK-ut.

Rukiqi: Korrupsioni dhe mosfunksionimi i gjykatave, ndër barrierat në të bërit biznes

Prishtinë, 2 shtator (ER) - Ekonomia joformale, energjia elektrike, korrupsioni janë disa prej barrierave të të bërit biznes në pesë vjetët e fundit në Kosovë. Kështu ka thënë kryetari i Odës

Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, në një konferencë për medie. Më tutje, Rukiqi ka thënë se nuk do të jenë të pranishëm në fushata të partive politike. "OEK-u nuk do të ndërlihet me

asnjë proces zgjedhor dhe nuk do të nënshkruajnë asnjë marrëveshje, a kontratë me parti politike para zgjedhjeve. E dyta, e kemi thënë edhe më herët, ne do të dalim me disa rekomandime

që të dalim me atë se çka kërkon sektori privat", ka thënë ai. Rukiqi ka thënë se edhe mosfunksionimi i gjykatave është duke shkaktuar barrierat në të bërit biznes.



Ministria e Tregtisë dhe Industrisë premtan eliminimin e barrierave tregtare me Shqipërinë



Pavarësisht prej nënshkrimit të disa marrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, barrierat tregtare vazhdojnë të jenë evidente në mes të dy ekonomive. Por, këshilltari politik në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Durim Limaj, ka thënë se kohët e fundit është bërë përparim në eliminimin e barrierave tregtare ndërmjet dy vendeve. Ai ka thënë se MTI-ja është duke u angazhuar për eliminimin e barrierave ekzistuese dhe shumë shpejt do të ketë zgjidhje për shqetësimet të cilat i ka ngritur komuniteti i biznesit

PRISHTINË, 2 SHTATOR (ER) - Kosova dhe Shqipëria në vitet e fundit kanë nënshkruar marrëveshje të shumta, por është evidente se ende nuk janë larguar barrierat tregtare ndërmjet dy vendeve. Gjatë këtij viti bilanci tregtar ndërmjet dy vendeve është mbi 100 milionë euro. Në periudhën janar-korrik të këtij viti, kompanitë nga Kosova kanë eksportuar në Shqipëri produkte në vlerë mbi 37 milionë euro, derisa ato të Shqipërisë në Kosovë sollën

prodhime në vlerë prej 129 milionë eurosh. Këshilltari politik në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Durim Limaj, në një përgjigje për "Radio Kosovën", ka thënë se në kohën e fundit është bërë përparim në eliminimin e barrierave tregtare ndërmjet dy vendeve. Ai ka thënë se MTI-ja është duke u angazhuar për eliminimin e barrierave ekzistuese dhe shumë shpejt do të ketë zgjidhje për shqetësimet të cilat i ka komuniteti i biznesit. Ndërsa kryetari i Aleancës

Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka thënë se vazhdimisht ka pasur tentime që për disa produkte të Kosovës të pengohet eksporti i tyre në Shqipëri. "Misioni ynë është i përbashkët, që vendet shqipfolëse të kenë mundësi të shkëmbimeve pa barriera. Pavarësisht prej të gjitha problemeve, vitin e kaluar shkëmbimi tregtar ndërmjet të dy vendeve ka qenë rreth 250 milionë euro. Të dy qeveritë po fillojnë dalëngadalë që të kuptojnë se bizneset janë aset që duhet

ruajtur, kultivuar, mbështetur dhe jo të pengohen", ka thënë Shahini. Edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se vazhdimisht kanë probleme tarifore me eksport në Shqipëri. "Për neve është më e rëndësishme që të gjitha këto barrierat të eliminohen me Shqipërinë, kur dihet se ka edhe synime politike që të kemi një treg sa më të bashkuar, të kemi sa më shumë mundësi bashkëpunimi të bizneseve të këtyre dy vendeve. Kjo deri tash nuk është e mundshme, dhe kur marrëveshjet fillojnë të implementohen, ka një pompozitet për to, por në rrugë të implementimit na dalin edhe shumë problem të tjera", ka thënë Rukiqi. Se a parashihen taksa ndaj Shqipërisë nëse nuk i largon barrierat ndaj produkteve të Kosovës, zyrtarë të MTI-së kanë theksuar se taksa është mjeti i

fundit që do të duhej të përdorej. Sipas tyre, janë duke u konsumuar të gjitha format e dialogut bilateral, në të kundërtën do të shqyrtohet trajtimi reciprok. Një gjë të tillë e ka mbështetur edhe kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini. "Kosova duhet ta heqë nga mendja vënien e taksave ndaj çdo shteti e aq më pak të mendojë për Shqipërinë për vënien e taksave, por duhet të mendohet se, nëse shterët dialogu për t'i hequr barrierat, atëherë duhet të merren masat e reciprocitetit ndaj secilit shtet në kushte të barabarta", është shprehur Shahini. Ai ka thënë se janë rreth 600 kompani aktive nga Shqipëria që importojnë në Kosovë, ndërsa janë një numër simbolik i kompanive nga Kosova që operojmë në Shqipëri, kryesisht për shkaqe burokratike dhe ngarkesave të ndryshme tatimore.

Grabitet një bankë në Shtime, Shoqata e Bankave e Kosovës e quan akt të shëmtuar kriminal

Shtime, 2 shtator (ER) - Të hënë në rreth orës 08:15 në rrugën "Tahir Sinani" në Shtime katër persona të armatosur kanë plaçkitur një bankë. Shuma e parave të grabitura nga plaçkitësit ende nuk dihet. Toger policor Agim Gashi ka bërë me dije se ka pasur edhe shkrepe arme në ajër nga ana e një të dyshuari, por nuk ka persona të lënduar. Ndaj kësaj gra-

bitje ka reaguar Shoqata e Bankave e Kosovës (ShBK). Kjo shoqatë e ka dënuar fuqishëm aktin e grabitjes me armë zjarri në një bankë në Shtime, me ç'rast ka kërkuar nga organet e rendit që sa më parë t'i sjellin para drejtësisë kryesit e këtij akti të shëmtuar kriminal, të cilët, nën kërcënimin e armës, rrezikuan sigurinë e punëtorëve, qytetarëve

dhe pjesëtarëve të policisë. "Grupet e tilla kriminale, të cilat synojnë t'i dëmtojnë bizneset e Kosovës, në veçanti bankat, e që rrezikojnë mirëqenien e qytetarëve dhe dëmtojnë rëndë imazhin e Kosovës, duhet të identifikohen sa më parë dhe të njëjtut ta marrin dënimin e merituar. Shoqata e Bankave e Kosovës, me qëllim të ngritjes së

sigurisë në sektorin bankar, në muajin shkurt të këtij viti ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës dhe Bankën Qendrore të Kosovës, me qëllim të avancimit të bashkëpunimit për ngritjen e nivelit të sigurisë në sektorin bankar në mënyrë që bankat, personeli i tyre dhe qytetarët të



kenë një ambient sa më të sigurt për zhvillimin e aktivitetit të tyre", është thënë në reagim e Shoqatës së Bankave të Kosovës (ShBK).

Prizreni nderon dëshmorët në 21-vjetorin e Epopesë së Vërrinit

PRIZREN, 2 SHTATOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Prizrenit, Eshref Memaj, së bashku me përfaqësuesit nga shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, zyrtarë komunalë, veteranë të luftës dhe qytetarë të tjerë, kanë bërë

homazhe në Hoçë të Qytetit, Jeshkovë dhe Malësi të Vërrinit, për t'i nderuar dëshmorët dhe martirët e rënë me rastin e 21-vjetorit të Epopesë së Vërrinit. Me këtë rast, nënkryetari Memaj ka thënë se është obligim i të gjithëve

që të kujtohen dhe të nderohen çdoherë ata që dhanë jetën për liri, derisa kontributi dhe sakrifica e tyre duhet të jetë frymëzim për gjeneratat e reja në mënyrë që të ndërtohet një shtet sa më i fuqishëm.



Nis ndërtimi i projektit milionësh në Gjakovë

GJAKOVË, 2 SHTATOR (ER) - Komuna e Gjakovës ka bërë me dije se ka filluar së ndërtuari vazhdimi i rrugës "Bujar Roka" në një gjatësi prej 2 731 metrash dhe me një kosto financiare që tejkalon 3.5 milionë euro.

Kryetari i Komunës, Ardian Gjini, ka thënë se ky projekt është një investim i jashtëzakonshëm. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se "asnjëherë nuk ka pasur vëllim kaq të madh investimesh në Gjakovë". Gjini ka thënë se këto investime janë duke u realizuar në këtë komunë falë mbështetjes së qeverisë Haradinaj.

Ndërsa ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka theksuar se përpos

këtyre projekteve, do të ndërtohet edhe autostrada e Dukagjinit. Në anën tjetër, kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka thënë se ky projekt është një arterie e nevojshme e qytetit të Gjakovës.

Më tutje, Haradinaj ka kërkuar nga punëtorët dhe punëkryesit që mos të bëjnë kompromise në kualitetin e ndërtimit. Aksi rrugor "Bujar Roka" deri tek Ura e Tabakut do të jetë një projekt i cili përfshin shtigjet për ecje, çiklizëm, gjelbërim, rrugën për qarkullimin e automjeteve me dy rrethrotullime dhe një urë që do të ndërtohet në kuadër të projektit.



10 nxënës nga Drenasi do të marrin pjesë në kampin veror në Gjermani



Në shtator 10 nxënës nga Drenasi marrin pjesë në kampin veror në Gjermani", ka thënë Lladrovci pas takimit me koordinatoren e projektit arsimor Gjermani - Kosovë, Kerstin Zielosko-Labonte

DRENAS, 2 SHTATOR (ER) - Kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka bërë me dije se arsimi në këtë komunë ka marrë mbështetje nga Finlanda, Gjermania dhe Austria. Në kuadër të kësaj mbështetje, Lladrovci ka thënë se në këtë muaj mesimdhënës nga Finlanda do të mbajnë mesim në shkollat e Drenasit. "Mbështetje për arsimin në Drenas nga Finlanda, Gjermania dhe Austria. Në shtator, mesimdhënës nga Finlanda mbajnë mesim në shkollat tona. Në shtator 10 nxënës nga Drenasi marrin pjesë në kampin veror në Gjermani", ka thënë

Lladrovci pas takimit me koordinatoren e projektit arsimor Gjermani - Kosovë, Kerstin Zielosko-Labonte nga Gjermania, si dhe shafen e Zyrës Ndërkombëtare të projekteve Erasmus+, Marina Grogger nga Salzburgu i Austrisë. Më tutje, Lladrovci ka thënë se me zyrtaret gjermane dhe austriake kanë diskutuar për arsimin në Drenas, për format e mbështetjes dhe të bashkëpunimit. "Të dy zyrtaret dhe njohëset e thella të fushës së arsimit dhe të reformave në arsim ma ofruan mbështetjen e tyre për shkollat tona", ka thënë Lladrovci.

Buxheti i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020 do të jetë mbi 2.7 milionë euro

HANI I ELEZIT, 2 SHTATOR (ER) - Komuna e Hanit të Elezit ka përmbyllur procesin e debateve publike me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, siç është projektbuxheti për vitin 2020 dhe parashikimet për vitet 2021-2022. Në gjashtë takime publike me banorët e fshatrave, lagjeve dhe vendbanimeve të komunës së Hanit të Elezit, pjesëmarrësit janë njoftuar me investimet që

do të realizohen gjatë vitit 2020. Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shabi Rexhallari, ka bërë me dije se, bazuar në qarkoren buxhetore 2020/01 dhe 2020/02, janë përcaktuar kufijtë e buxhetit sipas granteve buxhetore dhe burimeve të financimit. Ai ka thënë se buxheti fiskal për vitin 2020 për Komunën e Hanit të Elezit do të jetë 2 milionë e 742 mijë e 95 euro. Sipas tij, parashikimet për

vitin 2021 do të jenë në shumën prej 2 milionë e 846 mijë 397 eurosh, ndërsa për vitin 2022 do të jenë në shumën prej 2 milionë e 958 mijë e 963 eurosh. Ndërsa nga pjesëmarrësit në këto dëgjime publike janë pranuar shumë propozime konkrete, prej të cilave dominojnë problemet me furnizim me ujë, problemet me rrjetin e energjisë elektrike si dhe kërkesa për infrastrukturë publike.



Si të komunikohet me qytetarë gjatë fushatës zgjedhore?

Respektimi i privatësisë së qytetarëve gjatë komunikimit zgjedhor ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e besueshmërisë për subjektet politike që zhvillojnë komunikim të dinjitetshëm me ta



Shkruan: Jeton ARIFI

Tashmë që para-fushata zgjedhore jozyrtarisht ka nisur nga kandidatët potencialë për kreun e qeverisë së ardhshme, qytetarëve tanë po u jepet rasti t'i vlerësojnë kandidatë të tyre jo vetëm nga oferta konkrete për qeverisje të mirë, e cila lidhet kryesisht me drejtimin që do të marrë shteti, por edhe për nga mënyra e komunikimit që po zhvillohet drejtpërdrejt me fokus-grupe. Korrektësia e këtij komunikimi fillon që nga sigurimi i të

dhënave personale të zgjedhësve potencialë për t'i ftuar në bashkëbisedim, qoftë duke marrë shkas nga pjesëmarrja e tyre në një piknik rastësor, në një kolektiv prodhues apo edhe duke shpërndarë urime në ditën e parë të rifillimit të procesit mësimor.

Në thelb, zgjedhjet shihen kryesisht si mundësi për qytetarët që të ndikojnë te politikanët që të kenë një të ardhme më të mirë, por ato shfrytëzohen edhe si mjet, përmes të cilit, partitë politike dhe kandidatët e tyre mobilizojnë masën për t'i mbështetur ata që të bëhen zëri i tyre në kuvend.

Angazhimi i votuesve është i rëndësishëm në një demokraci të shëndoshë. Për ta arritur këtë, partitë politike dhe kandidatët zhvillojnë fushata duke përdorur mënyra të ndryshme komunikimi. Kontaktimi i individit përmes

cilësdo metodë për të promovuar synimet dhe idealet e një partie politike që të fitojë mbështetje për një parti apo kandidat, apo që të ndikojë tek individ, konsiderohet 'marketing i drejtpërdrejtë', aplikimi i të cilit është i rregulluar me ligj. Veprimet e një partie politike shihen me kujdes nga publiku, mediumet, KQZ dhe jo vetëm. Nuk është vetëm në interesin e partive politike që të veprojnë ligjërisht, veçse ato duhet të kenë respekt edhe për privatësinë e individëve që kërkojnë t'i përfaqësojnë, duke i trajtuar ata në mënyrë të drejtë. Fundja, trajtimi dinjitos i qytetarit në cilësinë e zgjedhësit nga ana e subjekteve politike, për sa i përket mënyrës së komunikimit që zhvillojnë me individë apo grupe qytetarësh, ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e besueshmërisë të ta. Përveç premtimeve e shpalosjes së vizionit të tyre qeverisës, deputetët mund ta kthejnë besimin e zgjedhësve edhe me mënyrën se si komunikojnë me ta, duke filluar nga vet sigurimi i ligjërisht i të dhënave kontaktuese dhe adresimi i porosive promovuese. Kandidatët për deputetë nuk duhen shfrytëzuar të dhënat kontaktuese të marra

gjatë kryerjes së funksionit të tyre paraprak për marketing të drejtpërdrejtë, përveç në rastet kur janë të sigurt që zgjedhësit në fjalë do ta prisnin kontaktimin prej tyre dhe nuk do të kundërshtonin.

Për më tepër, subjektet politike duhet ta respektojnë çfarëdo kërkesë me shkrim që e pranojnë nga ndonjë individ për të mos i dërguar materiale promovionale apo për të mos përpunuar të dhënat e tyre për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë (politik).

Nëse përdorin informata personale, siç është emri, adresa dhe çfarëdo informate që kanë rreth parapëlqimeve të një individ, për të promovuar një parti politike, duke u dërguar porosi promovionale me postë (elektronike), do t'u duhet të sigurohen që t'i përpunojnë të dhënat e tyre personale në mënyrë të drejtë dhe në të shumtën e rasteve të respektojnë ndonjë kërkesë eventuale për të mos pranuar informacione prej tyre. Në të gjitha komunikimet e tilla duhet ta identifikojnë veten dhe ta ofrojnë një adresë, të cilën qytetarët mund ta përdorin për ta kundërshtuar atë dhe për të kërkuar që të mos komunikojnë më me ta.

Më poshtë po shkoqis disa këshilla praktike që do të mund të aplikoheshin nga subjektet politike në raport me qytetarët gjatë fushatës elektorale:

-Bëhuni transparentë rreth shfrytëzimit të të dhënave të qytetarëve dhe respektoni preferencat e tyre;

-Përdorni ato vetëm në mënyra të përshtatshme me qëllimet, për të cilat, ju apo pala e tretë ofruese e ka informuar subjektin e të dhënave;

-Mos mblidhni më shumë të dhëna sesa ju duhen për qëllimin që ia keni treguar qytetarit;

-Sigurohuni që të mos i mbani të dhënat më gjatë sesa është e nevojshme për ti arritur ato qëllime;

-Mbani të dhënat të sigurt dhe fshini apo shkatëroni ato në mënyrë të sigurt, pasi të kenë shërbyer për qëllimin e caktuar;

-Respektoni të drejtat e individit për qasje në të dhënat e tyre personale që ju i mbani dhe të drejtën për të kundërshtuar shfrytëzimin e tyre nga ana e juaj.

(Autori është drejtor në Agjencinë për Informim dhe Privatësi)

Letër në ditën e parë të shkollës



Shkruan: Elizabetë QARRI

Të dashur nxënës, mësues dhe prindër,

Sot, në ditën e parë të shkollës, kur të gjithë njëloj po ndiejmë emocionet e vitit të ri shkolli, jemi krenarë që me duar e mendjen tonë po shkruajmë një të ardhme të re, për një shpresë e rrugëtim të për-bashkët. Në kohët më të vështira, kur botës i dëshmuam se arma jonë më e shenjtë është edukimi, bartëm nxënësit nga një lagje në tjetrën, nga një shkollë-shtëpi në tjetrën. E bëmë sepse ishte qëndresa jonë e fortë për të vërtetën më të kulluar, që në mendjet tona skaliti fort një maksimum, se edukimi është themeli nga i cili nis gjithçka.

Sot, më të ndërgjegjshëm se kurrë, mësuam se të edukosh

në një kohë krizash sociale e politike, ekonomike, morale e kulturore, nuk është mision i lehtë. Jemi të ndërgjegjshëm se puna vetëmohuese është pararojë e vetëdijes së lartë në shoqëri, rrugë e vetme për një qytetërim prosperues. E sotmja dhe e nesërmja jonë përkufizohen vetëm me edukim cilësor, me shkolla cilësore e mësues të motivuar.

Ne duam që shkollat tona të depolitizohen, t'i mbajmë larg mentalitetëve shfrytëzues e konsumues, atyre që denigrojnë vlera e shkaktajnë kriza në shoqëri. E krizat nuk tejkalohen pa afirmim të dijes, imperativ që duhet synuar të gjithë. Ne kemi nevojë për shkolla të reformuara e demokratizuara. Sot, në ditën e parë të shkollës, kujtojmë shumë fëmijë që pa fajin e tyre bankat e shkollës i zëvendësuan me trotualet e rrugëve, në udhëkryqet e ekzistencës së familjeve që dergjen nën mëshirën e egër të varfërisë. Sot jemi solidarë e bashkëndejmë me të gjithë fëmijët njëloj. Me unitet shpirtëror e moral, ndajmë bashkë si gëzimin ashtu edhe

dhembjen, duke mos harruar asnjëherë familjet shqiptare që nuk kursyen kurrë për shkolimin e fëmijëve. Të përmallur kujtojmë edhe ata nxënës që sot nuk patën fatin të shtrëngojnë duart me shoqet e shokët e klasës që, të përloitur e për një jetë më të denjë, braktisën bankat e shkollës dhe bashkë me familjet e tyre, mërguan e u

shpërndanë në çdo cep të botës. Duke mos e ditur se në ç'drejtim po nisen, lanë prapa vetëm shkëlqimin e syve të pafajshëm, për t'i kujtuar sot e gjithnjë me shumë mall.

Të dashur nxënës, mësues dhe prindër,

Le ta nisim sot rrugëtimin më të ri për sendërtimin e një

shoqërie me vlera, një shoqërie ku injoranca e padituria nuk zënë vend, një shoqërie ku garën e bëjnë të diturit e fituesin meritoret, një shoqërie ku suksesin e përcaktojnë të mençurit e jo të pasurit. Le ta nisim këtë rrugëtim drejt një shoqërie, ku të shpallësh fitues do të thotë t'i shpallësh luftë manipulimit dhe mashtrimit.

Le të mësojmë se e vërteta nuk gjendet gjithmonë te realiteti, por te krahasimi i realitetit me mundësitë e reja. E mundësitë e reja, shpeshherë rimëkëmbin shoqërinë, kthejnë dinjitetin e komunikimin e vërtetë njerëzor. Platoni shkruan: "Drejtimi në të cilin njeriu fillon edukimin e tij, i vendos gjithë të ardhmen e tij". Ndaj, le ta nisim sot këtë rrugëtim të për-bashkët, duke besuar e shpresuar në ligjësitë e një edukimi të suksesshëm, një edukimi që shtyn drejt prosperitetit dhe virtutit e vlera që ngrenë lart dinjitetin njerëzor.

Gëzuar ditën e parë të shkollës!

(Autorja është doktorante e edukimit dhe ligjëruese universitare)



Romani i magjishëm që “u shkrua vetë”

Nostalgji. “Kronikë në gur” i Ismail Kadaresë



"I thought for a long time about leaving Albania, but at the same time to play a role in its life".
-Ismail Kadare-

Kam venë re se në shumicën e rasteve ata që shkruajnë për veprën e Kadaresë-idhtarë të flaktë qofshim apo thjesht dashamirës, kritikë profesionistë apo “cmitizues” tendenciozë-bashkohen në vlerësimin me pikët maksimale për romanin e tij “Kronikë në gur”.

Kam përshtypjen se po të thirreshin në votim të gjitha kategoritë e lexuesve që përmenda më sipër “Kronikë...” do të votohej më shumë se romanet e tjera të Kadaresë. Edhe unë do ta votoja, pavarësisht se nga pikpamja e peshës, fuqisë dhe mjeshtërisë së të shkruarit është një roman i tejkaluar nga vetë Kadareja. Librat e mrekullueshëm të këtij shkrimtari, që u shkruan më pas, kanë gjithnjë diçka nga “Kronikë në gur”.

“Kronikë në gur” ngjan të jetë një lloj libri i librave ku embrionalisht u programua gjithë vepra e autorit. Në të njëjtën kohë “Kronikë në gur” është një vepër unikalë, e papërsëritshme. Më shumë se një roman tjetër i Kadaresë mendoj se atë e ka konkurrar dhe kaluar pjekuria e shkrimtarit. Unë gjithnjë e kam hequr mënjandë, domethënë e kam nxjerrë nga gara, kur më është dashur ta krahasoj me një vepër që dukej qartë se qëndronte më lart. Nuk mund ta përfshija në një sistem krahasimi, ku do më duhej ta kënaqja me medaljae argjendi apo bronci.

“Kronikë” ishte dhe mbetet për

mua një libër që mund edhe të kalohet, por s’mund të jetë i dyti. Kjo marrëdhënie kaq e veçantë me një libër lidhet edhe me faktin se bashkë me vëllimin me poezi “Fije bari” të Uollt Uitmanit, ky roman zbriti apo ndërhyri në moshën midis adoleshencës dhe rinisë sime me një prarim që kurrë nuk e kisha ndjerë. Gjithnjë e kujtoj si jam tronditur dhe përndritur kur e lexova për herë të parë. Besoj se jeta ime ndryshoi, në kuptimin që duke e ndjerë e kuptuar në mënyrën time, përceptova intuitivisht tragën e re të prozës moderne shqipe.

Më shumë se kaq- duhet ta them- në vetminë dhe mjerimin e jetës sime të atëhershme “Kronikë në gur” ishte një prej librave që krijoi një horizont, domethënë një strehë për pritjen e një adoleshenti të helmuar nga pamundësitë. Mendoja se kisha përse jetoja. Do të them përshtypjen e leximit të parë, të cilën e kam të gjallë sot e kësaj dite. Mua më dukej se këtë roman nuk e kishte shkruar njeri, por ishte shkruar vetë.

Shkrimtari i kishte fryrë pellëmbës së dorës si një magjistar dhe ja ku nga tymnaja mistike që ishte ngritur përpjetë kishin filluar të përftoheshin konturet e qytetit të Gjirokastrës, qytet i çuditshëm që dukej sikur kishte dalë në luginë papritur një natë dimiri si qenie prehistorike dhe duke u kacavjerrur me mundime të mëdha, i ishte

qepur faqes se malit; pastaj ishin përftuar Ismail Kadare fëmijë dhe shoku i tij Iliri, pastaj gjithë një fandaksje e jashtëzakonshme me gratë surreale në një minder të gjatë, Xhexhua, Selfixheja, Kako Pino dhe të tjerat duke marrë lajme e duke dhënë gjykime mbi punët e botës; me plakat e jetës, mbi njëqind vjeçe, që nuk i shihte kush në rrugë prej dekadash, njëra prej të cilave do të vdiste nën gërmadhat e bombardimeve duke pyetur “kush më vrau mua”; me Babazotin që pinte duhan me llullë, lexonte qitape dhe dëgjonte muzikën e jevgjëve që i jepej prej tyre si kompensim për qeranë e papaguar, me Dino Çiçon, shpikësin gotesk të aeroplanit prej druri, i madh sa një tabut, të cilin do ta merrte me vete mbi shpinë kur të evakuohej qyteti për të mos e lenë nën kërcenimin e bombardimeve, pastaj me radhë me Llukan Burgamadhin, që lirohej sa herë ikte një rregjim dhe kthehej në burg sapo vendosej rregjimi i ri edhe pse nuk kishte më një dënim për të, me Avdo Babaramon, mitralierin e vjetër, me Syrjanë që bëri të padëgjuarën duke venë syze, me Gjergj Pulajn që ndryshonte emrin duke ia përshtatur okupatorit të radhës, me Lame Kareco Spirun, të vluarin e shtëpisë publike që ndiqte nga pas më të qara kamionin që largonte nga qyteti prostitutat italiane, me

shih Ibrahimin që do të nxirrte sytë me gozhdë për të mos parë mbërritjen e partizanëve në qytet, me shumë e shumë të tjerë burra dhe gra.

Në magjinë e pëllëmbës, ashtu si personazhet, edhe ngjarjet kanë veshjen e groteskes. Edhe ato më tragjike. Përshkrimet e pushtimit të qytetit nga italianët, grekët, italianët përsëri, gjermanët, ballistët, partizanët jepen shpeshherë me notat e humorit të zi. Shkrimtari ka përdorur naivitetin si formë të vështruarit për të rrokur tërësinë e ngjarjeve kundërthënëse dhe për të dhënë me penelata të sakta larminë e tipologjive në teatrin e vogël ku lëvizin. Në gjithë këtë ndërthurje Gjirokastra duket si fundi i botës ku lufta e dytë botërore shihet në endërr marrëzinë e vet. Të paharueshme janë faqet ku përshkruhet Vasiliqia, një magjistare e shtirur me sy të skuqur dhe flokë të lëshuar, që grekët e lëshonin në qytet njëherë e një kohë për tu vënë gishtin atyre që duhej të vriteshin, të cilët ajo i caktonte pasi i shihte në sy.

Në një pikë të caktuar realiteti i së magjishmes dhe magjia e reales shkrihen në një një. Sidomos në kapituj e fundit të romanit që i kushtohen luftës. Gjithçka vjen dhe ikën, duke lënë pas gjurmën e një kujtimi, që me kalimin e kohës do të zbehet e tretet gjithashtu. Magjia që kemi parë të ngrihet nga pëllëmba e shkrimtarit i përcjell të gjithë dhe zhduket gjithashtu. Kurse qyteti i

gurtë, më i pjerrti në botë, mbetet ai që ka qenë, në përjetësinë e lëndës që e mban në këmbë.

Kadare ka thënë diku se këtë roman nuk e ka shkruar, por e ka mbledhur, pasi ngjarjet dhe personazhet kanë qenë gjithmonë përbri tij, rreth e rrotull tij. Nuk di të ketë thenë edhe dicka tjetër themelore për këtë roman, dicka që unë nuk e kam menduar dhe nuk mund ta mendoja kur e kam lexuar, por më vonë. Ky është romani që paralajmëron romanet e mëvonshme. Në faqet e “Kronikë në gur” gjejmë synopset e “Breznia e hankonatëve”, “Viti i mbrapshtë”, “Darka e gabuar”; gjejmë pikvështrime që shkrimtari do t’i rimarrë me vonë për t’i përpunuar në një nivel më të lartë të optikës së tij ideestetike.

Megjithëse i shkruar në periudhën e komunizmit, hyrja e partizanëve në qytet celebrimet me një akt terrorist të mirëfilltë, të cilën autori ka arritura t’ja rrëshqasë çensurës duke e paraqitur me naivitetin e fëmijës. Nga kjo pikpamje “Kronikë në gur” është jo vetëm libri i librave të Kadaresë, por edhe teksti i parë i koduar i një shkrimtari të cilin velat e talentit e çonin drejt lirisë së mendimit. “Kronikë në gur” u përkujton lexuesve të vjetër mrekullinë e leximit të një kryevepre te shkruar në shqip. Por “Kronikë në gur” mbetet një libër përherë i ri për lexuesit e rinj.

/Nga Preç Zogaj -gazetamapo.al/



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173


044 200 604

044 375 333

E rrallë

Gjarpri ngatërrohet me kafshën e gabuar

Një gjarpër boa në Brazil e ka pësuar keq derisa tentonte ta hante një iriq. Gjarpri për-pëlitet nga dhimbjet sepse është i mbushur i tëri me gjemba të iriqit, pasi tentoi ta mbyste atë. Zvarraniku e kishte shumë të vështirë të



lëvizte pasi gjembat e tij ndodhen kujtudo në trupin e tij.

FOTO E DITES



© Whale Watching Sydney

Një balenë është shfaqur në brigjet e Sidnejt. Për afro 90 minuta pasagjerët e një anije kanë shijuar spektaklin e balenës.

E jashtëzakonshme

Duke larë enët dhe fshirë shtëpinë, një burrë mundohet ta "joshë" gruan me foto seksi

Ne të gjithë kemi mënyrat tona se si i bëjmë punët e shtëpisë. Një burrë ka postuar në profilin e vet në "Facebook" një seri fotosh duke bërë punët të cilat kanë marrë 425 000 pëlqime dhe njerëz që e kanë komentuar. Duke përdorur fshesën me rrymë, duke larë enët dhe duke bërë punë të tjera shtëpie, Michael Onk ka shkruar si diçiturë në këto foto



frazën "Si t'i dërgosh foto seksi partneres tënde". Michael Onk e

ka një shpjegim për idenë e tij. "Ishte e premtë dhe shtëpinë e kishim rrëmujë. Gruaja ime po punonte vullnetare në një strehë për femrat e dhunuara dhe mua nuk më lejohej të qëndroja aty. Kështu që vendosa ta pastroja shtëpinë me themel. I hodha fotot në 'Facebook' sepse m'u dukën për të qeshur", ka shkruar Michael Onk.

BARSOLETA E DITËS



Gruaja dhe telefoni
Musa: Hoxhë, gruas sime i shndritë fytyra natën. Çfarë nënkupton kjo?
Hoxha: Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar.
Musa: Të lutem, më trego çfarë ka!
Hoxha: Asgjë nuk ka, vetëm se ka marrë telefonin tënd në duar.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30
The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
Regjia: David Leitch




Çdo natë në ora 21:30
ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.


Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Sot do të gjendeni përballë një problemi që ka të bëjë me punën tuaj. Nuk duhet ta lini pas dore.</p>	 <p>DEMI Vini në punë intuitën tuaj dhe zgjidhni mënyrën dhe rrugën me të thjeshtë për të dalë në përfundim të një situatë që ka ngecur prej kohësh.</p>	 <p>BINJAKËT Duhet të jeni pak më të ashpër me persona të caktuar sepse ju kanë vënë përballë probleme që do t'ju rëndojnë shumë sot.</p>	 <p>GAFORRJA Sot duhet t'i tregoni partnerit që do i gjendeni gjithmonë pranë, edhe në ato momente që duket sikur jeni larguar.</p>	 <p>LUANI Një marrëdhënie e caktuar mund të shkojë shumë më mirë nga sa e mendoni, nëse ju i lini hapësirë personave të tjerë t'ju gjenden pranë.</p>	 <p>VIRGJERESHA Sot vini në plan të parë zemrën tuaj dhe veproni siç ju thotë ajo. Mos merrni për bazë paragjykimet e të tjerëve.</p>
 <p>PESHORJA Do të kujtoheni në moment të fundit për një porosi që ju kanë lënë. Harresa juaj do të bëjë që një miqësi e vjetër të lëkundet.</p>	 <p>AKREPI Nëse akoma nuk e keni kuptuar se çfarë duhet të bëni mbase është mirë që të kërkonit ndihmë tek personat që keni pranë.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot jeni të bindur që po veproni mirë lidhur me një çështje të caktuar. Koha do të tregojë nëse keni pasur vërtet të drejtë.</p>	 <p>BRICJAPI Është mirë që të filloni të merrni me seriozitet anën emocionale tuajën. Kjo ju ndikon në gjithçka që do të bëni më vonë.</p>	 <p>UJORI Dikush po përpiqet t'ju hapë sytë dhe t'ju tregojë atë që duhet të bëni. Mundohuni të ruani intimitetin brenda dyerve të shtëpisë.</p>	 <p>PESHQIT Shumë herë me atë që thoni dhe bëni i çoni njerëzit të mendojnë ndryshe për ju. Kjo gjë ju intrigon dhe e bëni herë pas here.</p>


Martohet Miles Teller



Miles Teller është një burrë i martuar! Aktori 32-vjeçar është martuar me të dashurën Keleigh Sperry gjatë fundjavës në Hawaii,

raporton "E! News". Milesi i ka propozuar martesë modelueses 26-vjeçare në gusht të vitit 2017. Ata janë në lidhje që nga viti 2013.

Amber Rose shfaqet me barkun e rrumbullakosur



Amber Rose ka treguar barkun e rrumbullakosur derisa ka shijuar një ditë në Malibu. Ajo ishte e shoqëruar nga i dashuri i saj dhe djali gjashtëvjeçar. Në korrik

Amber dhe Alexander ishin parë duke bërë blerje për fëmijën e tyre i cili së shpejti vjen në jetë. Modeluesja ka njoftuar se ajo dhe i dashuri i saj janë në pritje të fëmijës gjatë muajit prill.



Miley Cyrus vazhdon të argëtohet me të dashurën e re

Përderisa është në proces të shkurorëzimit me ish-bashkëshortin e saj, Liam Hemsworth, Miley Cyrus vazhdon të kalojë kohë me blogeren Kaitlynn Carter. Ato janë parë duke darkuar pranë njëra-tjetrës, ku bashkë me to ishte edhe nëna e këngëtares Cyrus, Tish. Artistja 26-vjeçare është parë duke e përqaftuar ish-gruan e Brody Jenner, 30 vjeçe, pas puthjes që kishin dhuruar në liqenin Como të Italisë në muajin gusht.



Bukuroshet ishin veshur njëjtë me bluza të bardha dhe këngëtarja e hitit "Wrecking Ball" kishte të vendosur byzylykë të ndryshëm e unaza të shumta të arit.

Pitbulli anulon një koncert për t'u kujdesur për familjen

Pitbulli ka anuluar një koncert për hir të familjes së tij. Artisti 38-vjeçar e ka anuluar shfaqjen e planifikuar për të dielën në Los Anxhelos për shkak të uraganit "Dorian". Pitbulli, i cili është me qendër në Majami, ka vendosur të qëndrojë në Florida, derisa uragani ka goditur, në mënyrë që të kujdeset për sigurinë e familjes së tij. Koncerti tani është planifikuar të mbahet më 12 shtator.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Prekazi: Anglia favorite, por Kosova nuk dorëzohet



Strategu Rafet Prekazi është optimist se "dardanët" e rinj mund të marrin një rezultat pozitiv nga ndeshja eliminatorë ndaj Anglisë. "Realisht Anglia është kundërshtarja jonë më e fortë në këto eliminatorë. Në letër ata janë favoritë, por fusha jo gjithmonë e ka dëshmuar se është ashtu. Nuk kemi informata për këtë ekip U21 të anglezëve, pasi është ndërrimi i gjeneratës. Do ta analizojmë lojën e tyre përpara ndeshjes, ngase Anglia zhvillon një tjetër duel para nesh dhe më pas do të shohim për t'i marrë preventivat për këtë duel", ka thënë Prekazi

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës U21 në futboll më 9 shtator do të përballlet me Kombëtaren e Anglisë. Trajneri i "dardanëve" të rinj, Rafet Prekazi, e ka zbuluar të hënën listën e futbollistëve për këtë ndeshje. Ai ka thënë me këtë rast se Anglia është favorite në letër, por në fushë gjërat mund të ndryshojnë. "Realisht Anglia është kundërshtarja jonë më e fortë në këto eliminatorë. Në letër është favorite, por fusha jo gjithmonë e ka dëshmuar se është ashtu. Nuk kemi informata për këtë ekip U21 të anglezëve, pasi është ndërrimi i gjeneratës. Do ta analizojmë lojën e tyre përpara ndeshjes, ngaqë Anglia zhvillon një tjetër duel

para nesh dhe më pas do të shohim për t'i marrë masat për këtë duel", ka thënë Prekazi.

Në konferencë për medie ka qenë i pranishëm edhe futbollisti Eris Abedini, i cili ka lavdëruar anglezët e rinj. "Anglia është një kombëtare që ka shumë kualitet brenda. I njohim disa nga lojtarët që luajnë në Premierë Ligë dhe Championship dhe ne e dimë se do të jetë një ndeshje e vështirë. Mund t'ju them se sukseset e Kombëtares A kanë ndikuar te shumë futbollistë që ta zgjedhin kombëtaren e Kosovës përpara kombëtareve të tjera", ka deklaruar Abedini.

Futbollisti i skuadrës së Chiassos, Kreshnik Hajrizi, ka deklaruar se futbollistët e Kosovës e kanë rastin t'i dëshmojnë vlerat e tyre ndaj një

kundërshtari të fortë. "Do të jetë një ndeshje që mund t'i tregojmë kualitetet tona. Anglia është një ekip shumë i fortë, por ne duhet të tregojmë kualitetet që kemi. Kemi vetëbesim pasi futemi në këtë ndeshje nga pozita e parë me pikë maksimale", ka thënë Hajrizi.

Lista e futbollistëve

Florijan Smakiqi, Ardit Nika, Flamur Gashi, Shkëlqim Sadiku, Leonat Vitija, Kreshnik Hajrizi, Leard Sadiu, Lirim Kastrati, Arbenit Xhemajli, Lirim Mema, Besfort Kolgeci, Fuad Rahimi, Arton Zekaj, Gëzim Pepsi, Donat Hasanaj, Eris Abedini, Ismet Lushaku, Blend Baftiu, Lirim Kastrati, Ardit Gashi, Arbnor Muja, Valdrin Mustafa, Mirlind Daku.

SHKURT

Xhaka: Jam i zemëruar, por kurrë nuk dorëzohem

Londër, 2 shtator - Granit Xhaka ka shkaktuar penalti në ndeshjen derbi Arsenal-Tottenham Hotspur (2-2). Mesfushori shqiptar e ka pranuar gabimin që bëri dhe është shprehur i zemëruar, por premtos se nuk do të dorëzohet kurrë. "Faleminderit për përkrahjen e mahnitshme brenda 'Emirates'! Ne treguam karakter dhe ju na ndihmuat për t'u rikthyer në lojë. Për penalltinë, bëra gabim. Natyrisht se jam i zemëruar për këtë, por unë kurrë nuk do të dorëzohem", ka thënë Xhaka.

Ujkani në Torino

Kapiteni i Kosovës në futboll, Samir Ujkani, ka kryer vizitat mjekësore në skuadrën e Torinos dhe, sipas medieve italiane, ka nënshkruar kontratë njëvjeçare. 31-vjeçari ka qenë pjesë e Palermos, Novarës, Genoas, Chievos, Pisën, Cremonesës, Latinas dhe Rizesporit.

Maliqi përfaqëson Kosovën në Bullgari

Erdonis Maliqi do ta përfaqësojë Kosovën në Kampionatin Evropian U-18 të boksit i cili do të mbahet deri më 11 shtator në Sofje të Bullgarisë. Erdonisi, i cili është shpresë Olimpikë 2019, do të garojë në kategorinë deri në 69 kilogramë.

Natalija Milatoviç përforcon KHF Istogun

Hendbollistja e përfaqësueses së Malit të Zi dhe skuadrës ZRK Podgorica është hendbolliste e re e skuadrës së Istogut. Milatoviç ishte bashkuar me KHF Istogu në përgatitjet në Rozhajë dhe me sukses i ka kaluar provat te skuadra e qytetit të Istogut dhe ka nënshkruar marrëveshje njëvjeçare.

Katër shqiptarë në formacionin e javës në Zvicër

Në xhiron e gjashtë në kampionatin zviceran shkëlqeu futbollisti nga Kosova, Kemal Ademi, i cili shënoi dy gola te Baseli. Edhe Ermir Lenjani shkëlqeu me një gol në fitoren 1-0 të Sionit kundër Thunit, derisa për të asistoi Pajtim Kasami. Në ndeshjen e fundjavës, Servette barazoi 2-2 me Xamaxin, në një ndeshje ku talenti Kastriot Imeri dhuroi dy asistime për t'ia nxjerrë një pikë skuadrës së tij. Këta futbollistë janë përfshirë në formacionin e javës së gjashtë në Zvicër.

Vushtrria shkarkon Shotanin

VUSHTRRI, 2 SHTATOR - Kanë mjaftuar vetëm tri xhiro për tu zhvilluar në IPKO Superligën e Kosovës në futboll që të shkarkohet trajneri i parë. Bëhet fjalë për Bekim Shotanin, i cili

edhe zyrtarisht ka ndarë rrugët me skuadrën e Vushtrrisë. "Ju njoftojmë se pas mbledhjes së mbajtur me marrëveshje të dyanshme mes klubit dhe kryetrajnerit është vendosur për

ndërprerjen e marrëdhënies së punës me Bekim Shotanin, shfrytëzohet rastin që të falënderojmë publikisht për kontributin, duke i dëshiruar sukses dhe gjitha të mirat në të

ardhmen", thuhet në njoftimin e skuadrës së Vushtrrisë. Skuadra e rikthyer në Superligë në tri ndeshjet e para ka regjistruar dy humbje dhe një barazim.



Messi, Ronaldo dhe Van Dijk në garë për Lojtarin më të Mirë të FIFA-s

Paris, 2 shtator - Lionel Messi, Cristiano Ronaldo dhe Virgil Van Dijk janë nominuar në listën e ngushtë prej tre futbollistëve për çmimin Lojtari më i Mirë i FIFA-s. Kjo treshe ishte nominuar edhe për Lojtarin e Vitit të UEFA-s,

të cilin e fitoi Van Dijk javën e kaluar, duke u bërë mbrojtësi i parë që e fiton këtë çmim. Vitin e kaluar çmimin e rrëmbeu Luka Modriq i Real Madridit, duke i mposhtur në garë Cristiano Ronaldo dhe Mohamed Salah. Ndërkohë,

Pep Guardiola është i nominuar për Trajnerin më të Mirë të FIFA-s pasi e udhëhoqi Manchester City drejt tripletës në Angli. Në mesin e të nominuarve është edhe Jurgen Klopp pasi me Liverpoolin e tij e fitoi Ligën

e Kampionëve dhe Mauricio Pochettino i Tottenhamit. Messi është në garë edhe për një çmim tjetër, pasi goli i tij kundër Real Betisit në mars është i nominuar për Çmimin Puskas për golin më të mirë të sezonit të kaluar.



Balaj e Strakosha: Në Francë do të marrim pikë

TIRANË, 2 SHTATOR - Përfaqësuesja shqiptare ka filluar zyrtarisht grumbullimin ditën e hënë, ku do t'i bëjë përgatitjet për dy ndeshjet e radhës eliminatorë të "Euro 2020", ndaj Francës në transfertë më 7 shtator dhe me Islandën në "Elbasan Arena" më 10 shtator. Dy ndeshje të vështira, por edhe të rëndësishme për vazhdimësinë e objektivave tona për kualifikimin në Evropianin e ardhshëm. Edhe pse përballë do të jenë kampionët e botës, në ambientin kuqezi të gjithë mbeten në një mendje, që asnjë ndeshje nuk mbaron pa filluar ende.

Sulmuesi kuqezi Bekim Balaj shprehet në konferencën e parë për shtyp të kuqezinjtë, se në Francë do të kërkojnë pikë. "Të bëjmë paraqitje të mirë dhe të pretendojmë të marrim pikë edhe atje. Sigurisht ne me Francën kemi përvojë pozitive dhe për këtë arsye kemi një lloj detyrimi të marrim pikë edhe atje. Nuk është aspak e lehtë, por do të provojmë. Më vjen mirë që vij në kombëtare. Jam në një formë shumë të mirë dhe jam



aktivizuar në të gjitha ndeshjet me klubin tim, kam shënur dhe shpresoj të vazhdoj kështu edhe në ekipin kombëtar", është shprehur Bekim Balaj. Edhe Tomas Strakosha, portieri kuqezi i Lazios, u ka vënë theksin këtyre dy ndeshjeve, duke qenë se ky është një udhëkryq për objektivat tonë për Evropianin e ardhshëm. "Këto dy ndeshje do të tregojnë nëse jemi për kualifikim apo jo. Ne s'duhet të

mbingarkohemi, të stërvitemi dhe më pas të shohim çfarë do të ndodhë. Të dyja ndeshjet janë shumë të rëndësishme për ne. Sa i përket aktivizimit tim, nuk ka rëndësi nëse luaj unë apo Etriti, konkurrenca gjithmonë bën mirë. Ne i kemi kualitetet, por vetëm kur luajmë si grup mund të bëjmë mirë edhe me rezultatet", ka thënë portieri i Lazios, Tomas Strakosha.

Djokoviqi tërhiqet nga US Open, Federeri shkon në çerekfinale

NJU JORK, 2 SHTATOR - Një dëmtim në shpatull e ka detyruar tenistin serb Novak Djokoviq të tërhiqet nga grand slam i US Openit. Numri 1 në botë për meshkuj, në ndeshjen e raundit të katërt, po luante ndaj zviceranit Stanislas Wawrinka. Në shifrat 2-0 me sete për Wawrinka (2-1 për zviceranin me game në setin e tretë), Djokoviqi vendos të tërhiqet nga ndeshja, duke mos mbrojtur dot titullin kampion. Në çerekfinale shkon edhe një zviceran tjetër, Roger Federer, që mundi me lehtësi 3-0 (6-2, 6-2, 6-0) belgun David Gofn. Ndeshje e mirë për Federerin, që pati epërsi në të tre setet, duke dominuar në lojë dhe e meritoi kualifikimin.

Nuk zhgënjën bullgari Grigor Dimitrov, që mundi 3-0 (7-5, 6-3, 6-4) australianin Alex De Minaur, duke avancuar në çerekfinale. Një biletë për në çerekfinale siguroi edhe rusi Daniil Medvedev, që mundi 3-1 gjermanin Dominik Koepfer, raporton "Telesport".

Serena Williamsi është kualifikuar për në çerekfinale të grand slam të US Openit, pas fitores 2-0 (6-3, 6-4) ndaj kroates Petra Martić. Tenistja amerikane, finaliste një vit më parë, po tregon një formë të mirë, gjithnjë e



në rritje nga ndeshja në ndeshje. Ndaj Martić ajo pati epërsi në të dy setet, duke luajtur mirë dhe e meritoi fitoren. Surprizë eliminimi i tenistes australiane Ashleigh Barty, fituese e Roland Garros këtë vit, që u mund 2-0 (6-2, 6-4) nga kinezja Qiang Wang. Një eliminim i papritur i ish-numrit 1 në botë, që ndaj një rivale pak të njohur, bëri një paraqitje të dobët. Tenistja britanike Johanna Konta mundi 2-1 (6-7, 6-3, 7-5) Karolina Pliskovën në ndesh-

jen më të bukur të raundit të katërt të luajtur të hënë. Pliskova e nisi mirë ndeshjen, duke fituar në "tie-break" setin e parë, por shpejt Konta rikuperoi, duke fituar me përmbyse. Fitoi edhe tenistja ukrainase Elina Svitolna, që mundi 2-0 (7-5, 6-4) amerikanen Madison Keys, finaliste në këtë turne dy vjet më parë. Edhe pse Keys kishte mbështetjen e publikut, kjo nuk mjaftoi, me Svitolna që u tregua më e saktë në fushë.

SHKURT

Mkhitaryani huazohet te Roma

Mesfushori Henrikh Mkhitaryan është huazuar në skuadrën e Romës nga Arsenali me një marrëveshje njëvjeçare, por me mundësi të blerjes. 30-vjeçari kaloi në Arsenal nga Manchester Unitedi në janar të vitit 2018 si pjesë e marrëveshjes së transferimit të Alexis Sanchez në "Old Trafford". Tetëmbëdhjetë muaj më vonë të dy lojtarët janë huazuar në Serinë A te Roma, përkatësisht Interi. Krahas Mkhitaryanit, nga Arsenali janë larguar edhe Nacho Monreal (Real Sociedad) dhe Mohamed Elneny (Beshiktash).

'Chicharito' te Sevilla

Sevilla ka nënshkruar me sulmuesin Javier Hernandez, i cili do të jetë pesë e skuadrës spanjolle për tre vjetet e ardhshme. Ndërsa çmimi që ka paguar për 31-vjeçarin është 8 milionë euro. Transferimi i Sebastien Hallerit nga Eintracht Frankfurti në korrik bëri që Hernandezi ta humbte vendin në skuadrën e West Ham Unitedit, kurse transferimi në La Liga ishte zgjedhja e sulmuesit meksikan. Hernandezi në vitin 2017 ishte transferuar në West Ham nga Bayer Leverkuseni për 16 milionë euro. Ish-sulmuesi i Manchester Unitedit dhe Real Madridit bëri 55 paraqitje në Premier Ligë për West Hamin, kurse shënoi 16 gola.

Llorente, lojtar i ri i Napolit

Sulmuesi Fernando Llorente është lojtar i ri i skuadrës së Napolit. 34-vjeçari është larguar në fund të sezonit të kaluar nga Tottenham Hotspuri, kurse skuadrës italiane i bashkëngjitet si lojtar i lirë. Llorente ka luajtur edhe për Juventusin, Athletic Bilbaon, Sevillan dhe Swansea Cityn.

Darmiani largohet nga Unitedi, shkon te Parma

